

Shënime historike mbi festën e Krishtlindjes

Origjina e kësaj feste sipas *Liber Pontificalis*, ndërlidhet me periudhën e Papës Telesforit (125-136), mirëpo, festa e Krishtlindjes ka filluar të kremtohet rreth mesit të shekullit IV në Romë. Këtë na e dëshmon fakti se, në *Depositio Martyrum filocaliana*, pjesë nga Kalendari liturgjik i vitit 336 lexojmë: “VIII Kal. Jan. Natus Christus in Bethleem Judae”. Pastaj, nga perëndimi kjo festë bartet edhe në Lindje së pari në Antioki rreth vitit 375 nga Shën Gjon Gojarti, dhe si karakteristikë e festës është kremtimi i tri Meshëve, praktikë kjo që u lejohej të gjithë meshtarëve, mirëpo më herët kjo gjë ishte e rezervuar vetëm për Papën. Mesha “*Ad galli cantum*” nuk përmbante si sot ndonjë karakteristikë të Meshës së ditës së festës, por ishte Flija me të cilën përmbyllej vigjilja e së Kremtes. Autori i biografisë së Papës Telesforit në *Liber Pontificalis* shkruan se pikërisht ky Papë ka filluar ta praktikoj dhe këndoj “*Glloria in excelsis*” në Meshën e Mesnatës.

Në anën tjetër, në Jerusalem të krishterët zakonisht bashkoheshin në Betlehem për të kremtuar këtë festë, edhe atë pikërisht te vendi i Lindjes së Jezu Krishtit.

Shën Luani i Madh, Papë, lidhur me këtë festë shkruan: “Zgjohu o njeri, dhe njihe dinjitetin e natyrës tënde. Le të bie ndër mend se je krijuar në përngjasimin e Hyjit (Zan 11, 26), dhe se ky përngjasim i humbur në Adamin, është përtërirë në Krishtin”.

